

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE DEGA NË LIPJAN**, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarin G. L., rr. “D.”, F., të cilin e akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.1778/2016 të dt.19.12.2016, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë për dhënien e urdhrit ndëshkimor me dt. 24.04.2017 muarr këtë :

## **A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-së në Prishtinë PP.II.nr.1778/2016 të dt.19.12.2016 dhe kjo gjykatë jep këtë:

## **URDHËR NDESHKIMOR**

Ndaj te pandehurit:

G. L., , nga i ati L., i lindur me dt. *data e lindjes...*, në F., rr. “D.”, në F. ku dhe jeton me nr. personal *numri përsonal...*, Shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## **Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse :

Me dt.24.03.2016, rreth orës 13:00 në magjistralen Prishtinë – ferizaj, në udhëkryqin e fsh. G., i pandehuri G. L., derisa ka qenë duke e drejtuar automjetin e tipit “Audi A6”, me ngjyrë të gjelbert, me targa të regjistrimit *numri i tabelave...*, nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën dhe ka dëmtuar trupin e njerëzve dhe pasurin, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 64 par.1 dhe par.2 të ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugorë, nuk e ka rrespektuar të drejtën përparësisë së kalimit në udhëkryq, ashtu që me të arritur në udhëkryqin duke mos e rrespektuar shenjë “Stop”, merr veprimin e kyqjes në magjistrale dhe kthim në të majtë në drejtimi të Ferizaj pa u ndalur fare, kalon në shiritin e magjistrales “ Ferizaj-Prishtinë” dhe me pjesën e parë të anës së djathtë e godet autom jetin e tipit “ Toyota”, me ngjyrë hiri me targa të regjistrimit, Police 192-01, të cilin e drejtonte i demtuari H. F. nga fsh. K. K. M., pastaj pas goditjes i pandehuri kalon në anën e kundërt të drejtimit dhe me pjesën e anës së djathtë e godet automjetin e tipit “Fiat Punto”, me ngjyrë të zezë, me targa të regjistrimit *numri i tabelave...*, të cilin e drejtonte i demtuari B. U. nga fsh. G. e U. K. L., me ç’rast të dëmtuarve B. U. dhe H. F. iu shkakton lëndime të lehta trupore, si dhe dëm material në automjete, andaj-

- me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform dispozitave të neneve 1, 2, 4, 7, 8, 17, 21, 23, 41, 42, 43, 46, 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së si dhe neneve 365,493 dhe 495 të KPPRK-së, të akuzuarin e :

## G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 300.-€ (treqindëeuro), të cilin dënim është i obliguar t'a paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata konform nenit 46 KPRK-së dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim ashtu që për çdo ditë të dënimit, do të llogaritet shuma prej 20.-€.

**Të dëmtuarit:** B. U. dhe H. F., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

**OBLIGOHET** i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 60.88.-€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20.-€ pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP/II.nr.1778/2016 të dt.19.12.2016 e ka akuzuar të pandehurin G. L. nga F., rr. "D.", për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, të njëjtën datë ka kërkuar që ndaj të pandehurit, të shqiptohet urdhër ndëshkimor-dënim me gjobë për veprën e cekur penale.

Gjykata duke i shiquar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës nga kallëzimi penal i dt.25.03.2016, ekspertizës së ekspertit të komunikacionit L. K. e dt.14.08.2016, ekspertizës së ekspertit mjeko-ligjor Dr. V. H. e dt. 14.07.2016 si dhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës, së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtet ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv.

Me dispozitën e nenit 493 KPPK-së, parashihet se " Për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me prova të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkoj në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor në të cilin të akuzuarit do ti shqiptoj dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor".

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj te akuzuarit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë apo me burgim deri në 1 vit, andaj gjykata konform dispozitave të lartëcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u bazua në nenin 450 par.2 pika 1 dhe 6 e KPPK-së.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në kontest të rregullt civil u bazua në nenin 463 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE, DEGA NE LIPJAN**

**P.nr. 861/16 me dt.24.04.2017**

**Sekretarja juridike,  
Nexhmije Ahmeti**

**GJYQTARI,  
Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej 8 dite nga dita e dorëzimit të së njëjtit. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate.